



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

(Draft 3, Version 1 datë 18.04.2014)

Nr. _____, datë _____

“PËR KUFIZIMIN E SHKARKIMEVE TË PËRBËRSVE ORGANIKË TË AVULLUESHËM NGA PËRDORIMI I TRETËSVE ORGANIKË NË DISA BOJRA, LLAQE DHE PRODUKTE PËR LUSTRIMIN E MJETEVE”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës “b” të nenit 14 të draftit 3, versionit 3 të Ligjit nr _____, datë ____ “Për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajër më të pastër”, me propozim të Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të parandalojë ose të pakësojë ndotjen e ajrit, që rezulton nga kontributi i përbërësve organikë të avullueshëm në formimin e ozonit troposferik, nëpërmjet kufizimit të përmbajtjes totale të përbërësve organikë të avullueshëm në disa bojra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve.
2. Ky vendim mbulon produktet e përcaktuar në Aneksin I. Ai përcakton specifikimet teknike për disa bojra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve.
3. Ky vendim nuk bie në kundërshtim dhe nuk prek masat e marra, përfshirë kërkesat për etiketimin, për mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve dhe të punonjësve, si dhe mjedisin e tyre të punës.

II. PËRKUFIZIME

4. Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a. “**AKM**” është Agjencia Kombëtare e Mjedisit sipas përcaktimit të Ligjit nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
 - b. “**Bojra dhe llaqe**” janë produktet e listuara në nënkategoritë I të Aneksit 1 të këtij vendimi, me përjashtim të aerosolëve. Këto janë veshje që përdoren në ndërtesat, finiturat dhe stukimet, si dhe në strukturat shoqëruese për qëllime mbrojtje, funksionimi dhe dekorimi.
 - c. “**ISHMPU**” është Inspektoriati Shtetëror për Mjedisin, Pyjet dhe Ujërat sipas përcaktimit të Vendimit nr. 46, datë 29.1.2014 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”;
 - d. “**Ministër**” është ministri përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit;
 - e. “**Ministria**” është ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit;
 - f. “**Përzierje**” janë përzierjet ose solucionet e përbëra nga dy ose më shumë substanca;
 - g. “**Përbërës organik**” është çdo përbërës që përmban të paktën elementin karbon dhe një ose më

¹ Ky vendim përafrohet direktivën 2004/42/CE për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm për shkak të përdorimit të tretësve organikë në disa bojra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve dhe amendon direktivën 1999/13/EC FZ L 143, 30/04/2004 fq. 0087 - 0096

- shumë elementë hidrogjeni, oksigjeni, squfuri, fosfori, silici, azoti ose halogjeni, me përjashtim të oksideve të karbonit, karbonateve inorganike dhe bikarbonateve;
- h. "**Përbërës organik i avullueshëm (VOC)**" është çdo përbërës organik që ka një pikë vlimi fillestare më të ulët se ose të barabartë me 250°C të matur në presion standard prej 101,3 kPa;
 - i. "**Përmbajtje VOC**" është masa e përbërësve organikë të avullueshëm e shprehur në gramë/litër (g/l), në formulimin e produktit për ta bërë të gatshëm për përdorim. Masa e përbërësve organikë të avullueshëm në një produkt të dhënë, i cili reagon kimikisht gjatë tharjes për të formuar pjesë të veshjes nuk konsiderohet pjesë e përmbajtjes së VOC;
 - j. "**Produktet për lustrimin e mjeteve**" janë produktet e listuara në nënkategoritë 2 të Aneksit I këtij vendimi. Ato përdoren për lyerjen e mjeteve rrugore sipas përcaktimit në Udhëzimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit nr.11, datë 6.6.2011 "Për miratimin e tipit të mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre, të sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësisve të veçanta teknike të destinuara për këto mjete" ose pjesë të tyre, të përdorura si pjesë e riparimit të mjeteve, ruajtjes ose dekorimit jashtë instalimeve të prodhimit.
 - k. "**Substancë**" është çdo element kimik dhe përbërës i tij, në gjëndjen e tyre natyrale ose si janë prodhuar nga industria, qoftë kjo në formë të ngurtë, të lëngët ose të gaztë;
 - l. "**Shtresë**" është një shtresë e pandërprerë që rezulton nga përdorimi i një ose më shumë veshjeve në një nënshtresë; "**Tretës organikë**" është çdo VOC i cili përdoret vetëm ose në kombinim me agjentë të tjerë për të tretur ose holluar lëndët e para, produktet ose mbetjet e materialeve. Tretësi organik përdoret edhe si agjent pastrimi për të tretur lëndët ndotëse, si shpërndarës mesatar, rregullues i viskozitetit, rregullues i tensionit sipërfaqësor, plastifikues ose si lëndë konservuese;
 - m. "**Veshje**" është çdo përzierje, përfshirë të gjithë tretësit organikë ose përzierjet që përmbajnë tretës organikë të nevojshëm për përdorimin e tyre të përshtatshëm, e cila përdoret për të siguruar një shtresë me efekte dekoruese, mbrojtëse ose funksione të tjera në një sipërfaqe; "**Veshje me hollues uji (HU)**" janë veshjet, viskoziteti i të cilave rregullohet nga përdorimi i ujit;
 - n. "**Veshje me hollues tretës (HT)**" janë veshjet, viskoziteti i të cilave rregullohet nga përdorimi i tretësit organik; "**Vendosje në treg**" është bërja e disponueshme e produktit për palët e treta, me ose pa pagesë. Importimi në territorin doganorë të Republikës së Shqipërisë konsiderohet vendosje në treg për qëllime të këtij vendimi.

III. KËRKESAT

5. Vlerat kufi maksimale për përmbajtjen e VOC në disa bojra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve janë përcaktuar në Aneksin II.
6. Produktet e përcaktuara në Aneksin I ndalohen të vendosen në treg në territorin e Republikës së Shqipërisë përpara datës së përcaktuar në Aneksin II, me përjashtim të rasteve kur ato përmbajnë VOC që nuk i kalojnë vlerat kufi të parashikuara në paragrafin 5 dhe janë në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun IV.
7. ISHMPU ose çdo laborator i akredituar i punësuar prej tij, për të përcaktuar përputhshmërinë me vlerat kufi të përmbajtjes së VOC të përcaktuara në Aneksin II, përdorë metodat analitike të parashikuara në Aneksin III.
8. Për produktet e përcaktuara në Aneksin I në të cilët, për ta bërë produktin të gatshëm për përdorim, shtohen tretës ose përbërës të tjerë që përmbajnë tretës, vlerat kufi në Aneksin II zbatohen për përmbajtjen e VOC në produktin e gatshëm për përdorim.
9. Pavarësisht nga sa është parashikuar në paragrafët 5 deri në 8, produktet e shitura për përdorim të veçantë në një veprimtari të mbuluar nga Vendimi nr...datë "Për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime" dhe të kryer/prodhuar në një instalim të rregjistruar ose për të cilin është lëshuar një leje mjedisi në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun III dhe IV të këtij Vendimi përjashtohen nga zbatimi i kërkesave të mësipërme.
10. AKM mund të lëshojë rast pas rasti autorizime individuale për shitje dhe blerje në sasi të kufizuara strikte të produkteve që nuk arrijnë vlerat kufi të VOC të përcaktuara në Aneksin II, vetëm për qëllime restaurimi dhe mirëmbajtje të ndërtesave dhe mjeteve vintage të përcaktuara

nga Ministria përgjegjëse për kulturën, si me vlera të veçanta kulturore dhe historike.

11. Produktet që janë objekt i këtij Vendimi të cilat tregojnë se janë prodhuar përpara datës së përcaktuar në Aneksin II dhe nuk përmbushin kërkesat e paragrafit 6 mund të vendosen në treg për një periudhë 12 mujore nga data kur kërkesat që zbatohen në produktin në fjalë hyjnë në fuqi.
12. AKM mund të mbajë ose të marrë masa për kontrollin e shkarkimeve nga veprimtaritë e lustrimit të mjeteve që nuk janë mbuluar nga Vendimi nr...date..“Mbi kufizimin e përbërësve organikë të avullueshëm për shkak të përdorimit të tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime”.

IV. LËVIZJA E LIRË

13. ISHMPU, sipas rregullave të vendosura në këtë Vendim, nuk ndalon, kufizon ose parandalon vendosjen në treg të produkteve që janë objekt i këtij vendimi, të cilët në kushtet kur janë të gatshme për përdorim, përputhen me kërkesat e këtij vendimi.

V. ETIKETIMI

14. Mbi produktet e përcaktuara në Aneksin I kur vendosen në treg vendoset etiketë. Etiketa tregon:
 - a. nënkategorinë e produktit dhe vlerat kufi përkatëse të VOC në g/l referuar në Aneksin II;
 - b. Përmbajtjen maksimale të VOC në g/l të produktit të gatshëm për përdorim.

VI. INSPEKTIMI

15. ISHMPU harton dhe zbaton programin e monitorimit për inspektimin e produkteve të vënë në treg për të verifikuar përputhshmërinë me kërkesat e këtij vendimi.

VII. RAPORTIMI

16. ISHMPU dhe AKM hartojnë përkatësisht dy raportet e mëposhtme dhe i dërgojnë ministrisë rezultatet e programit të monitorimit për të demonstruar:
 - a. përputhshmërinë me këtë vendim, si dhe
 - b. kategoritë dhe sasinë e produkteve të autorizuar në përputhje me dispozitat e parashikuara në paragrafin 10 të Kreut III.
17. Dy raportet e parë paraqiten 18 muaj pas datës për përputhshmëri me vlerat kufi të përmbajtjes të VOC të përcaktuara në Aneksin II. Më pas raportet paraqiten çdo 5 vjet.
18. Formatit për paraqitjen e të dhënave nga monitorimi miratohet me Urdhër të Ministrit.
19. Të dhënat vjetore bëhen të disponueshme në faqen elektronike të ministrisë.

VIII. AUTORITETI KOMPETENT

20. Ministria, AKM dhe ISHMPU janë autoritetet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

IX. HYRJA NË FUQI

21. Ky vendim hyjnë në fuqi 5 vjet pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ANEKSI I

Nënkategoritë 1:

- a) "veshje mat për mure të brendshëm dhe tavane" janë veshjet e projektuara për përdorim në mure të brendshëm dhe tavane me një shkallë shkëlqimi $\leq 25@60^\circ$.
- b) "veshje me shkëlqim për mure të brendshëm dhe tavane" janë veshjet e projektuara për përdorim në mure të brendshëm dhe tavane me një shkallë shkëlqimi $>25@60^\circ$.
- c) "veshje për mure të jashtme me përbërje minerale" janë veshjet e projektuara për përdorim në mure të jashtëm betoni, tulle ose stuko;
- d) "bojra për lëmim dhe bllokim brenda/jashte për dru, metal ose plastik" janë veshjet e projektuara për përdorim në pjesët e prera dhe veshje që prodhon një shtresë të errët. Këto shtresa projektohen për dru, metal ose sipërfaqe plastike. Kjo nënkategori përfshin nënveshjet dhe veshjet e ndërmjetme;
- e) "bojra lëmuese dhe ujëbllokuese për dru brenda/jashte" janë veshjet e projektuara për përdorim në pjesët e prera e cila prodhon një shtresë transparente ose gjysëm transparente për dekorim dhe mbrojtje të drurit, metalit dhe plastikës. Kjo nënkategori përfshin veshje ujëbllokuese me ngjyrë të errët. Veshje ujëbllokuese me ngjyrë të errët janë veshjet që prodhojnë një shtresë me ngjyrë të errët për dekorimin dhe mbrojtjen e drurit, ndaj kushteve atmosferike, sipas përcaktimit në standardin EN 927-1, brenda kategorisë gjysëm të qëndrueshme;
- f) "veshje ujëbllokuese për dru" është veshja ujëbllokuese e cila, në përputhje me EN 927-1:1996, ka një trashësi mesatare më pak se $5\mu\text{m}$ kur testohet në përputhje me ISO 2808: 1997, metodën 5A;
- g) "astar" janë shtresa me veti mbylljeje dhe/ose bllokuese të projektuara për përdorim në dru ose mure dhe tavane;
- h) "astar lidhes" janë veshje e projektuara për të stabilizuar humbjen e grimcave të lëndëve ose transmetimin e vetive hidrofobike dhe/ose për mbrojtjen e drurit nga njollat blu;
- i) "veshje një komponente me performancë të lartë" janë veshjet me performancë të lartë mbështetur në material shtresë formuese. Ato janë projektuar për përdorim i cili kërkon një performancë të veçantë, të tillë si astar dhe veshje të sipërme për plastikën, veshje astar për sipërfaqe hekuri, veshje astar për metale reaktive të tillë si zinku dhe alumini, veshje antikorrozive, veshje për dysheme, përfshirë dyshemet e drurit dhe çimentos, kundër grafitëve (vizatime/mbishkrime", zjarr vonues dhe standardet higjienike në industrinë ushqimore ose të pijeve ose shërbimin shëndetësor;
- j) "veshje bi-komponente me performancë të lartë" janë veshjet me të njëjtin përdorim si veshjet me një komponent me performancë të lartë, por me një përbërës të dytë (e.g. tertiary amines) të shtuar përpara përdorimit;
- k) "veshjet shumëngjyreshe" janë veshjet e projektuara për të dhënë efektin e dy toneve ose të efekteve shumëngjyresh, drejtpërdrejt nga përdorimi fillestar;
- l) "veshjet për efekt dekoruese" janë veshjet e projektuara të japin efekte estetike të veçanta mbi lëndë paralyerje të përgatitura posaçërisht ose veshjet bazë dhe të trajtuara më pas me mjete të ndryshme gjatë periudhës së tharjes.

Nënkategoritë 2:

a) "përgatitës dhe pastrues" janë produktet e projektuara për të hequr veshjet e vjetra dhe ndryshkun, mekanike ose kimike ose të sigurojë një çelës për veshje të reja:

(i) produktet përgatitore që përfshijnë dhe ato për pastrimin e pistoletave sprucuese" (produkt i projektuar për pastrimin e pistoletave sprucuese dhe pajisje të tjera), pastrues boje, pastrues yndyre (përfshirë llojet anti-statike për plastikë) dhe heqësit e silikonit;

(ii) "parapastrues" janë produktet e pastrimit të projektuara për heqjen e ndotjes sipërfaqësore gjatë parapërgatitjes për dhe përpara përdorimit të materialeve të veshjeve;

b) "stukim/mastic" janë përbërësit e rëndë strukturor të projektuara për përdorim për mbushjen e papërsosmërive të thella të sipërfaqjes përpara përdorimit të bazë/mbushësit;

c) "astar" është çdo veshje që është e projektuar për përdorim në metale të zhveshura ose veshjet ekzistuese për të siguruar mbrojtje nga korrozioni përpara përdorimit të astarit sipërfaqësor:

(i) "baze/mbushës" është veshja e projektuar për përdorim menjëherë përpara përdorimit të veshjes së sipërme për qëllime rezistence ndaj korrozionit, për të siguruar ngjitjen e veshjes së sipërme dhe për të promovuar formimin e një veshje sipërfaqësore uniforme duke mbushur papërsosmëritë e vogla sipërfaqësore;

(ii) "astar i përgjithshëm për metale" janë veshje të projektuara për përdorim si astar, të tillë si promovuesit e ngjitësit, izolues-hermetizues, sipërfaqësor, nënveshjet, astarët plastik, veshje mbushese "te njome mbi te njome" jo-lemuese dhe veshje mbushese me sprucim;

(iii) "astar fosforik" janë veshjet që përmbajnë të paktën 0,5 % të peshës së acidit fosforik të projektuar për përdorim të drejtpërdrejt në sipërfaqe metalike të zhveshura për të siguruar rezistencë ndaj korrozionit dhe ngjitjes; veshjet e përdorura si astar saldues; dhe solucion zbutës për sipërfaqe të galvanizuara dhe zinku;

d) "veshja e sipërme" është çdo veshje e pigmentuar e projektuar për t'u përdorur si një shtresë e vetme ose si bazë e një shtrese të shumëfishtë për të siguruar shkëlqim dhe qëndrueshmëri. Ajo përfshin të gjitha produktet e përfshira si veshje bazë dhe veshje transparente:

(i) "veshje bazë" janë veshjet e pigmentuara të projektuara për të siguruar ngjyrën dhe çdo efekt optik të dëshiruar, por jo shkëlqim ose rezistencë sipërfaqësore të sistemit veshës;

(ii) "veshje transparente" është një shtresë transparente e projektuar për të siguruar shkëlqimin përfundimtar dhe vetitë rezistente të sistemit veshës;

e) "veshje speciale" janë veshjet e projektuara për përdorim si veshje të sipërme që kërkojnë cilësi të veçanta, të tilla si efekte metalike ose perlë në një shtresë të vetme, ngjyrë të fortë me performance të lartë dhe veshjet transparente, (psh kundra gervishjes dhe veshje transparente me fluor), veshje bazë reflektuese, efekte me relief (psh. çekiç), anti rreshqitëse, veshje izoluese për karroceri, veshje kundra gureve, veshje për finitura të brendshme dhe aerosol.

ANEKSI II

A. Vlerat kufi të përmbajtjes maksimale të VOC për bojra dhe llaqe

	Nënkategoritë e produktit	Lloji	Faza I (g/l (*)) (nga 1.1.2007)	Faza II (g/l (*)) (nga 1.1.2010)
a	Mure të brendshme dhe tavane mat (shkëlqimi <25@60°)	HU	75	30
		HT	400	30
b	Mure të brendshme dhe tavane të shkëlqyeshëm (Shkëlqimi >25@60°)	HU	150	100
		HT	400	100
c	Muret e jashtme me perberje minerale	HU	75	40
		HT	450	430
d	bojra per lemim dhe bllokim brenda/jashte për dru dhe metal	HU	150	130
		HT	400	300
e	bojra lemuese dhe ujebllokuese per dru brenda/jashte, përfshirë veshje ujebllokuese me ngjyrë të errët	HU	150	130
		HT	500	400
f	veshje ujebllokuese per dru brenda/jashtë	HU	150	130
		HT	700	700
g	Astare	HU	50	30
		HT	450	350
h	Astare lidhës	HU	50	30
		HT	750	750
i	veshje nje komponente me performancë të lartë	HU	140	140
		HT	600	500
j	veshje bi-komponente me performance te larte për përdorim specifik të tillë si dyscheme	HU	140	140
		HT	550	500
k	Veshje shumëngjyrëshe	HU	150	100
		HT	400	100
l	Veshje me efekt dekoruese	HU	300	200
		HT	500	200

(*) g/l gati për përdorim

B. Vlerat kufi të përmbajtjes maksimale së VOC për produktet për lustrimin e mjeteve

	Nënkategoria e produktit	Veshje	POA g/l (*) (1.1.2007)
a	Përgatitës dhe pastruese	Përgatitës	850
		Parapastrues	200
b	stukim/mastic	Të gjitha llojet	250
c	Astar	baze/mbushes dhe astar i përgjithshem per metale	540
		astar fosforik	780
d	veshja e siperme	Të gjitha llojet	420
e	veshje speciale	Të gjitha llojet	840

(*) g/l të produktit të gatshëm për përdorim. Me përjashtim të nënkategorisë “a” çdo përmbajtje uji të produktit të gatshëm për përdorim duhet zbritur.

ANEKSI III

Metodat referuar në Kreun III, paragrafi 7

Parametri	Njësi	Test	
		Metoda	Data e publikimit
Përmbajtja e VOC	g/l	ISO 11890-2	2002
Përmbajtja e VOC kur janë të pranishëm holluesit reagues	g/l	ASTMD 2369	2003